



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 1442 / Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

**PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR**

**Datë 12.09.2024 ora: 17:00**

**Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë**

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

**Marrin pjesë:**

*Kryetari i Bashkisë Vlorë-z.Ermal Dredha; Nënkryetari i Bashkisë, z. Klevis Kaso; Administratori i Njesisë Administrative, z. Genard Fegaj; Anëtarë të Këshillit Bashkiak; Kryetarë fshatrash dhe banorë të njesisë administrative; Përfaqësues nga administrata e bashkisë dhe nga institucionet në vartësi të bashkisë,*

*(Në takim morrën pjesë më shumë se 24 persona, listëprezenca bashkangjitur)*

**Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha:** Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për të prezantuar projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Vlorë 2025-2027 si dhe buxhetin e vitit 2025.

Është punuar, sigurisht që nuk i kemi realizuar të gjitha. Jemi duke lobuar. Përsa i përket investimeve të parashikuara dhe sa janë realizuar, në njësinë tuaj:

-Rikonstruksioni i rrugës së shkollës në fshatin Babicë e Madhe, me vlerë rreth 15.7 milion lekë/vjetra. Projekt i përfunduar, pritët zbatimi.

-Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Babicë e Madhe, me vlerë 91 milion lekë /vjetra

-Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatit Xhyherinë, vlerë 29.7 milion lekë/vjetra.

-Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Xhyherinë, (segmenti lidhës rruga nacionale – qendër )me vlerë rreth 29.8 milion lekë.

-Rikonstruksioni i rrugëve në fshatin Bestrovë.

-Projekt i parkimit, ka filluar si projekt me FSHZH, me vlerë 25 milion lekë, në hyrje të ishullit, fshatin Zvërnec.

-Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në fshatin Kaninë.

-Rikonstruksioni i rrugës lidhëse së Kaninës me 7 pallatet , me vlerë 240 milion lekë/rinj, kërkesë në FSHZH. Projektin e ka bërë bashkia dhe e kemi çuar tek FSHZH.

-Projekti i dy pikave panoramike.

Projekti Shtegu i Kaninës, me vlerë 30 milion.

-Rehabilitimi i qendrës së fshatit si dhe rehabilitimin e rrugëve të brendshme të fshatrave si Kaninë, Babicë, Kërkovë, bashkëpunim me FSHZH.

Këto janë pak a shumë disa nga investimet e parashikuara dhe sa kemi arrit për realizimin e tyre. Janë bashkëpunim me qeverinë dhe, kryesisht me FSHZH. Problemi i ujit të pijshëm është pak problematik.

**Z.Pajtim Çapi/Punonjës i Ujësjetllësit** – Rrjeti shpërndarës është pak problematik. Do tenderohet. Do shohim mundësinë për ndryshimin e pompës.

**Z.Albert Hasani/Kryetar i fshatit Xhyherinë** – Babica e Vogël ka ujë 24 orë, kurse tek ne akoma jo. Për punën e pompës, u pastruan sondat, pusi u tha. Pompa që ka vendosur Qarku, kollona ka pësuar devijim. Të vijë specialisti. Të vijnë të nxjerrin pompën, të furnizohemi me ujë. Xhyherina s'ka ujë. Deri në 25 gusht, kemi qenë mirë me furnizimin me ujë.

**Z.Ermal Dredha** – Edhe në Njësinë Novoselë edhe pse është bërë Ujësjetllësi, ka pas pak probleme me disa fshatra. Ujësjetllësi, ka marrë një dakortësi, do bëhet dhe një projekt që do të përfshijë 10 fshatra.

**Z.Lavdosh Hoxhaj /Kryetar i fshatit Sherishtë**- Ta nis me arritjet. Është punuar me ndriçimin, por akoma kemi nevojë. Na duhen 10 shtylla dhe 600 m kabëll.

**-Ujësjetllësi.** Na është premtuar që do bëhet një pus, i cili na ndihmon. Kemi shumë pak ujë dhe taksat i paguajmë në rregull.

-Një riveshje të rrugës kryesore deri tek "Vranarajt". Kërkojmë një riveshje.

-Segmenti nga qendra e fshatit – varreza , gjysmën e rrugës e ka bërë një firmë,"Fetahu". Ju mund të na jepni mjetin, skrepin për të hapur kanalën.

Nga "Vranarajt ", si dhe rruga e Fermës "Kanina " .

Për Sherishtën, çfarë do të bëhet.

**Banor** – Jam banor ndër vite. Nuk janë pasojat nga ju, por të mbartura. Nuk e marrët çdo gjë në kohën e vet, pra dhe do tolerojmë. Në fshatin tonë, nuk është bërë gjë. Është e vështirë të bëhen të gjitha, por të fillohet.

Në fshatin Babicë, problemi i ujrave të zeza. Për 100m që të derdhen në kanalën e ujrave të zeza.

-Kam parë projektin e linjavë të mirëmbajtjes së ujit. Ne kemi besim tek ju .

Pra, rrjeti është problem; Rruga është shumë keq.

Dua të falenderoj drejtorin e ndriçimit, që me të çuar ankesë- kërkesë , erdhi, nuk hezitoi dhe vuri, rregulloi ndriçimin.

**Zoti Kryetar!** Duhet parë ku janë gjërat me delikate.

-Të na sillni 2 bote me ujë, për momentin . Unë kam besim tek ju se, do ndërhyni.

**Banor/Sherishtë** – Kam qenë prezent kur Kryeministri premtoi për rrugën e Labërisë.

-Transporti urban, është shqetësim për fshatin. Ç'farë ka thënë Kryeministri e ka bërë, por punën e bën me ju. I bëhet mirë gjithë qytetarëve, gjithë banorëve. E kam diskutuar dhe me drejtorin e shërbimeve. Të vihen tabelat me orare. Ky është një problem shumë jetik.

Linja Babicë – Alikokë – Qishbardhë.

**Z. Islam Isakaj/Kryetar i fshatit Hoshtimë** – Falënderoj Juve zoti Kryetar dhe administratën për punën e bërë deri tani.

Kemi nevojë, për rreth 600 m rrugë në fshatin Hoshtimë; 10 ndriçues ; rruga nga hyrja deri në fshat.

Këtë dhjetor do të dorëzohet dhe rruga , por rruga nuk ka cilësi të mirë, po çahet. Kujdes, kur ta marrni në dorëzim.

**Z. Ermal Dredha** – Nuk e kemi marrë akoma në dorëzim. Për Babicën e Vogël, rruga nacionale tek rrotonda, do të bëhet.

**Z. Islam Isakaj** – Problemin e llampave, rrjetin e brendshëm e kemi në rregull, por pastrimin e kanalit nga liqeni.

**Z. Ermal Dredha** – Kjo është për zotin Dorianin, NSHP.

**Z. Islam Isakaj** – Rrjetin e kemi shumë mirë.

**Z.Anesti Korreeta/Kryetar i fshatit Bestrovë** – Falenderoj Kryetarin për premtimin e bërë dhe të mbajtur, për rrugën e bërë. Por kemi dhe disa probleme:

-Problem uji i pijshëm. Ndonjë projekt për depo uji

-Rruga është shumë e mirë por ka nevojë dhe për gjëra të tjera.

-Rruga Bestrovë – Bunavi, ka pësuar çarje, duhet të vini ta shikoni. Rruga e kamionëve ka qenë nga çezma e thatë. Do prishet ajo rrugë.

**Z.Ermal Dredha** – Do ta shikojmë.

**Z.Avdul Yzeiri/Kryetar i fshatit Babicë e Madhe** – Problemi i ujit është shumë urgjent.

Rrugët janë bërë keq. Shikojeni me urgjencë problemin e ujit.

**Z.Edmond Habilaj/Kryetar i fshatit Babicë e Vogël** – Faleminderit për lajmin e mirë që do të fillojë rruga.

-problemi është rruga e varrezave të fshatit, rreth 400m.

Kemi ujë 24 orë, s’kemi problem

-Furgonin e kemi me orar, por vetëm që s’ka vendqëndrim, stacion.

**Banor** –Uji i pijshëm shumë problem. Ndryshimi që u bë vjet.., sot kemi nevojë për ndriçues. Shtyllat janë , mungojnë ndriçuesit. -Problem , transporti i fëmijëve për në shkollë.

**Z.Ermal Dredha** – Nuk është detyra jonë, jo për ta anashkaluar por do diskutojmë me Drejtorinë Arsimore . Ka lidhje me Ministrinë e Arsimit. Për ndryshimin ...

**Z.Edison Kapaj /Anëtar i KB-** Falenderim në emër të banorëve të fshatit Kërkovë dhe të njësisë.Problem për fshatin Panaja

-Rrugët e brendshme,

-Nevojitet në mënyrë emergjente lidhja e tubacioneve për fshatin Panaja , për ujin e pijshëm por , problem janë dhe kanalet e ujrave të zeza.

-Edhe ndryshimi në fshatin Panaja është problem.

**Z.Vangjel Profka/Kryetar i fshatit Nartë** – Falenderim për ndryshimin, në fshatin Nartë.

Ka dhe probleme të tjera;

-Kanalizimet janë problem

-Rruga kur shkon për në kishë, është shumë e keqe.

Faleminderit.

**Z.Bareq Sadiraj/Kryetar i fshatit Kaninë** – Për PBA 2025 – 2027, bëtë mirë që dëgjuam premtimet.

Kemi problem, kërkojmë rikonstrukcionin e rrugës lidhëse Kaninë – Sherishtë.

-2500 m mbi “Bishtin e Kalldrëmit .

-rrjeti është shumë i amortizuar. Na nevojitet një depo e re uji.

**Z.Ermal Dredha** – Tubon e kemi gjetur, do ta sjellim.

**Z.Bareq Sadiraj** – Zoti Zambak, tre lagje i kemi pa drita.

**Z.Ermal Dredha** – I kemi bërë kërkesë FSHZH . Është bërë miratimi i buxhetit të FSHZH dhe do të merren parasysht dhe ndahen sipas bashkive.

**Z.Bareq Sadiraj** – Rruga Sherisht – Kaninë, 600m. Stabilizantin do ta garantoj unë.

Duhet një eskavator, është rrugë për tu hapur dhe për tu bërë kanalet .

-Për ndriçimin, problem “Bishti i Kalldrëmit “- Kaninë , duke qenë se jemi dhe fshat turistik.

**Banor/Bestrovë – Zoti Kryetar!** Keni bërë shumë për fshatin Bestrovë, si për rrugën ..Keni bërë edhe pse duhet akoma, ka shumë projekte që nuk varren nga ju. Ka ndryshime në shumë zona.

**Z.Ermal Dredha** – Faleminderit të gjithëve!

**Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik**

**Albana Naçi**